

Paola

LEZHË

Eta është 14 vjeçe dhe para disa vitesh ka humbur babain. Për shkak të pamundësisë së saj ekonomike, shokët dhe shoqet e klasës e ngacmojnë. Sikur të mos mjaftojë, ajo vuan edhe nga disa probleme shëndetësore.



Eta është edhe e sëmurë nga veshkat, gjë që herë pas here i sjell shqetësime.



Së fundmi është prekur edhe nga sëmundja e rrjebullës që i shkakton shenja në lëkurë, por që bëhet shkas për ngacmim nga ana e disa bashkëmoshatarëve. Sëmundja e saj e lëkurës nuk është ngjitëse dhe do vite për tu kuruar plotësisht.



Pavarësisht se nuk është ngjitëse sërisht fëmijët e tallin dhe i thonë je me zgjebe. Në fillim ajo nuk ua vuri shumë veshin, por duke qenë se ata vazhdonin njëllonj, çdo ditë, Eta filloi t'i përjetonte shumë këto situata.



Erdhi një moment që Eta u ndie aq ngushtë saqë u drejtua për ndihmë tek drejtorja e shkollës.



Pavarësisht se ngacmimet dhe fyerjet nuk ndaluan plotësisht, shumë prej nxënësve ndryshuan sjellje e filluan ta mbronin nga të tjerët.